



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Ligjit Nr.06/ L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2 e datës 15 shkurt 2018 ,nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës nxjerr këtë :

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE PËR TATIMIN NË PRONËN E**  
**PALUAJTSHME PËR VITIN 2022**

**Neni 1**  
**Normat Tatimore**

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, **caktohen** normat tatimore për vitin 2022, për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike dhe mbesin të njëjta si në vitin 2021 , me shënimet si vijon:

- Për njësitë bujqësore të parcelave----- 0.15 %
- Për njësitë bujqësore të objekteve----- 0.15 %
- Për njësitë pyjore të parcelave----- 0.15 %
- Për njësitë rezidenciale të parcelave----- 0.15 %
- Për njësitë rezidenciale të objekteve----- 0.15 %
- Për njësitë komerciale të parcelave----- 0.30 %
- Për njësitë komerciale të objekteve----- 0.30 %
- Për njësitë industriale të parcelave----- 0.20 %
- Për njësitë industriale të objekteve----- 0.20 %

**Neni 2**  
**Zbatimi**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa –Sektori për Tatim në Pronë.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe fillon të zbatohet nga 1 janari 2022 dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa –Sektori për Tatim në Pronë.

## Arsyetim

Me dispozitat e nenit 9 të Ligjit të Nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme është përcaktuar obligimi i Kuvendeve Komunale që të caktojnë normat tatimore për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike deri me 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit në përputhje Ligjin mirëpo meqenëse Kuvendi i Komunës së Lipjanit ashtu si të gjitha kuvendet komunale të komunave tjera të Republikës së Kosovës nuk ka mundësi ligjore të funksionalizohet dhe të marrë vendim për caktimin e normave tatimore në periodën e caktuar me Ligj- muajin nëntor 2021 për shkak të organizimit zgjedhjeve të rregullta lokale, Kryetari i Komunës në koordinim edhe me Drejtoratin për Buxhet dhe Financa- Sektorin e Tatimit në Pronë vendosi që normat tatimore për vitin 2022 të jenë të njëjta si në vitin 2021, ashtu që në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, **caktohen** normat tatimore për vitin 2022 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike siq përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Nga të cekuarat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

1Nr. 1-431-72691  
Lipjan më 23. 11. 2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

